



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më 10.11.2025

**MBLEDHJA Nr. 46,
Datë 13.11.2025, ora 09:00
e Bordit të ERE-s.**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 13.11.2025, ora 09:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 46 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga FMF për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin Tetor 2025.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “INFOTELECOM-ALBSOLAR 4” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
4. Mbi rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 197, datë 15.08.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë “Këlcyra 2020” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Klisyrë” me kapacitet prodhues 2 MW”.
5. Mbi rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 160, datë 18.07.2025 “Mbi pezullimin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me kërkesën e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar”.
6. Mbi miratimin e “Rregullores së alokimit të kapaciteteve afatgjatë (FCA)”.
7. Mbi miratimin e “Një udhëzuesi për balancimin e energjisë elektrike”.
8. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. për miratimin e “Kodit të rjetit mbi emergjencën dhe rivendosjen”.
9. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 93, datë 28.04.2025, “Mbi miratimin e rregullores së alokimit të kapaciteteve dhe menaxhimit të kongjestionëve”.

10. Mbi miratimin e “Udhëzimit për mënyrën e pasqyrit të konsumit të energjisë elektrike në faturën mujore, identifikimin e ndarë të kategorive të konsumatorëve dhe zbatimin e çmimeve përkatëse”.

11. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI